

Pozicion Vakant

Balkan Finance Investment Group, , BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Holandë, me afërsisht 6,000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Balfin Real Estate & Hospitality është pjesë e Grupit BALFIN dhe mbulon shërbime shitje & marketing në fushën e Real Estate dhe shërbime akomoduese në industrinë e turizmit, duke ofruar në treg një ekspertizë të nivelit të lartë.

Pozicioni: Shofer në Green Coast Resort and Residences

Departamenti: Burime Njerëzore

Vendndodhja: Palasë, Vlorë (Green Coast Resort and Residences)

Përmbledhja e Pozicionit:

Shoferi i kompanisë është në shërbim të Balfin Real Estate and Hospitality për çdo nevojë që paraqitet për transportin e stafit, dokumenteve, aseteve si dhe në pritje-përcjellje të punonjësve të huaj që rekrutohen.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Mbulon detyra mbi transportimin e stafit të Balfin Real Estate and Hospitality, dokumenteve/ aseteve mbi bazën e nevojave që paraqiten rast pas rasti dhe në orarin e kërkuar;
- Mban përgjegjësi për çdo dëmtim të makinës;
- Mirëmban automjetin me të cilin punon;
- Furnizon automjetin me karburant kur është e nevojshme;
- Mban të informuar periodikisht eprorin direkt për çdo eventualitet apo nevojë për mjetin;
- Ndjek serviset periodike të automjetit pranë servisit të miratuar në përputhje me librin e shërbimeve, si dhe procesin vjetor të dokumenteve bazë që kërkohen për mjetin (Taksat vjetore + Siguracioni + Kolaudimi etj.)
- Të jetë i gatshëm për të dërguar dhe marrë porosi të ndryshme për kompaninë në kuadrin e blerjeve të vogla që bën kompania;
- Përgjegjës për transportin e sigurtë dhe në kohë të porosive dhe stafit;
- Përgjegjës për respektimin e rregullave të trafikut;
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e ditarit të udhëtimeve dhe kilometrave të kaluara;

Ekspierencat e punës:

- Përvojat e përgjithshme në këtë fushë jo me pak se 5 vjet në të njëjtën fushë.

Aftësi të tjera:

- Leje drejtimi automjeti (Klasi B);
- Njohës i gjuhës angleze;
- Diplomë e shkollës së mesme ose të lartë;
- Fleksibël në orar;
- Dinamik në kryerjen e proceseve të punës, në kohë, cilësi dhe saktësi.

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit në adresën hr@balfinrealestate.al me subjekt: **Shofer në Green Coast Resort and Residences.**

Afati i dorëzimit: [25/06/2022](#)

*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".